

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nuk jam kundër Muzeut Hebraik në Vlorë. Jam kundër histerisë rreth tij
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/nuk-jam-kunder-muzeut-hebraik-ne-vlore-jam-kunder-histerise-rreth-tij-i585914
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:23:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f138daca6b25e7a43f9b5176385f8a15d2915017a89ba2d5cddf41d66544652
TEKSTI	60f7c2fe97c20a1c3d83213ce2eff64f718229fe93ae5623335f3fb0b9ca6331
PAMJA	f6ef7387e4bb4a0142a31e161554f8e499517ad33752c3e688248342104f0954

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cd2cf2cff583f70b190c27b7dd48b05c20220d0c574ce93f8e4a1fcb3850edca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cd2cf2cff583f70b190c27b7dd48b05c20220d0c574ce93f8e4a1fcb3850edca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

le Rama uron nxenesit per nysjen e vitit te ri shkollor: Shkolla te rilindura me standarde te reja Viti i ri shkollor/ Ministria Kumbaro uron nxenesit: Me shume kushte bashk fundit

Nuk jam kundër Muzeut Hebraik në Vlorë. Jam kundër histerisë rreth tij



14 Shtator 2026, 08:40Blog Nga Ardi Stefa

Të jem i qartë, ngaqë në Shqipëri shpesh debati nis aty ku duhet të mbarojë. Të mbështesësh një muze nuk do të thotë të heqësh dorë nga historitë e tjera; të kritikosh një projekt nuk do të thotë të jesh kundër një populli, një besimi apo një kujtese.

Unë nuk jam kundër ngritjes së një Muzeu Hebraik në Vlorë. Përkundrazi, çdo muze që pasuron kujtesën historike të qytetit dhe vendit është i mirëpritur, nëse ndërtohet me seriozitet, transparencë dhe standarde muzeale.

Por po aq qartë jam pro një muzeu për Labërinë, Çamërinë, për Kosovën dhe për historitë e tjera shqiptare që meritojnë të dokumentohen, të studiohen dhe t'u përcillen brezave.

Dhe jam pro pasurimit e modernizimit të muzeumeve që kemi, sepse nuk mund të pretendojmë se ruajmë kujtesën tonë kombëtare duke i lënë muzeumet të plaken bashkë me vitrinat e tyre.

Problemi për mua nuk është muzeu hebraik por folklorizmi dhe nacionalizmi kallp që shndërron çdo debat publik në një betejë patriotësh kundër tradhtarëve.

Është ajo logjika primitive sipas së cilës, nëse dikush thotë "po" për një projekt, duhet medoemos të ketë thënë "jo" për një tjetër.

Sikur kujtesa historike të jetë një tortë me copa të kufizuara: një pjesë për hebrejtë, një për Çamërinë, një për Kosovën, dhe kur mbaron njëra, nuk mbetet më për tjetrën.

Jo! Kujtesa nuk është pronë me metra katrorë. Një shoqëri serioze nuk trembet nga shumëllojshmëria e historive të saj. Ajo i vendos ato në dialog.

Në mund të tregojmë historinë e hebrenjve në Vlorë e Shqipëri (ku hebrenjtë ishin pjesë e qenësishme e jetës sonë ekonomike, kulturore e historike) dhe njëkohësisht historinë e Çamërisë. Mund të nderojmë shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të flasim pa frikë për dëbimet, vuajtjet dhe padrejtësitë që kanë përjetuar shqiptarët. Mund të kujtojmë Kosovën dhe njëkohësisht të dokumentojmë historinë e komuniteteve të tjera që kanë jetuar në hapësirën shqiptare.

Nuk ka asnjë kontradiktë këtu. Kontradikta qëndron vetëm kur historia përdoret si armë politike.

Dhe këtu duhet të jemi veçanërisht të kujdesshëm: sa herë një muze propozohet, dalin menjëherë "analistët" e Facebook-ut, hartuesit e teorive konspirative dhe patriotët me tastierë që zbulojnë prapaskena ndërkombëtare pa pasur lexuar as një dokument.

Një muze nuk ndërtohet me thashetheme. Historia nuk shkruhet me britma. Dhe patriotizmi nuk matet me numrin e konspiracioneve që mund të shpikësh brenda një dite.

Nëse kemi kundërshtime për vendndodhjen, financimin, përmbajtjen, mënyrën e kurimit, transparencën apo përdorimin e hapësirës publike, t'i diskutojmë seriozisht. Me dokumente, argumente dhe standarde.

Por të mos e kthejmë Vlorën në një skenë ku çdo projekt kulturor interpretohet si komplot dhe çdo pyetje si tradhti.

Vlorës i duhen më shumë muzeume, jo më shumë histeri. I duhet një muze hebraik, nëse ai dokumenton me dinjitet një pjesë të historisë së qytetit.

I duhet një muze për Çamërinë.
I duhet një hapësirë serioze muzeale për Kosovën (veç asaj ekzistuese) dhe historinë kombëtare.
I duhen muze të modernizuar, arkiva të digjitalizuara, ekspozita bashkëkohore dhe histori të treguara me dokumente, jo me legjenda.

Një qytet që respekton historinë e vet nuk ka frikë të tregojë të gjithë historinë.

Këtu është ndryshimi mes kujtesës dhe folklorit:
Kujtesa kërkon të vërtetën.
Folklori kërkon duartrokitje.
Unë zgjedh të parën.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Puq institucional i 'Republikës së Magjistratëve'?

19:10 Blog / 8 komente

Ju nuk na përfaqësoni!

18:00 Blog / 7 komente

[Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor](#)

16:13 Blog / 20 komente

Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA

12:00 Blog, 54 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.